

# RAPORTI VJETOR 2023





NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT

**RAPORTI VJETOR 2023**

## DORËZIMI I RAPORTIT VJETOR NË BORDIN MBIKËQYRËS TË NJIF-K

---

I nderuar z.Hekuran Murati  
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve,  
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K

Të nderuar anëtar të Bordit Mbikëqyrës të NJIF-K,

Në cilësinë e U.d.Drejtorit të Njesisë për Inteligjencë Financiare (NJIF-K) kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin vjetor të vitit 2023. Në këtë raport përvijohen aktivitetet e Njesisë për Inteligjencë Financiare (NJIF-K) në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Raporti Vjetor për vitin 2023 dorëzohet në përputhje me nenin 10(1) të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.

NJIF-K ka pasur një vit efektiv në menaxhimin e të gjitha aspekteve të kërkimit, marrjes, analizimit dhe shpërndarjes së informatave tek autoritetet kompetente lidhur me aktivitetet e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Duke bashkëpunuar me njerëzit përreth, kemi arritur rezultate të kënaqshme që përfshinë: fuqizimin e vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizës strategjike; ngritjen e bashkëpunimit dhe Koordinimit Kombëtar dhe rishikimi i efektivitetit të sistemit kombëtar të PPP/LFT; forcimin e legjislacionit kombëtar për PPP/LFT dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore (legjislacionit sekondar) duke forcuar standardet e brendshme të NJIF-K, sigurimin e implementimit të tyre efikas dhe duke ofruar udhëzime për subjektet raportuese; fuqizimin e strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe masat parandaluese; zhvillimin, standardizimin dhe intensifikimin e proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave.

Në përfundim, vlerësoj maksimalisht përpjekjet dhe përkushtimin e stafit të NJIF-K, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur arritjen e rezultateve të prezantuara në këtë raport.

Sinqerisht,

Behar Xhema

Ushtrues Detyre/Drejtorit, Njësia për Inteligjencë Financiare

# PËRMBAJTJA

<i>I. POLITIKAT DHE KOORDINIMI VENDOR PËR PPP/LFT</i>	5
VLERËSIMI I RREZIKUT, MENAXHIMI RREZIKUT DHE KORNIZA STRATEGJIKE	6
BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI KOMBËTAR DHE RISHIKIMI I EFEKTIVITETIT TË SISTEMIT KOMBËTAR TË PPP/LFT	7
FORCIMI I LEGJISLACIONIT KOMBËTAR PËR PPP/LFT	8
<i>II. MBIKËQYRJA E PAJTUESHMËRISË DHE MASAT PARANDALUESE</i>	10
MBIKËQYRJA E BAZUAR NË RREZIK	11
BASHKËPUNIMI PËR MBIKËQYRJEN E PAJTUESHMËRISË	13
PARTNERITETI PUBLIK-PRIVAT	15
<i>III. MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA</i>	17
MBLEDHJA E INFORMACIONIT FINANCIAR	18
ANALIZA DHE MONITORIMI	25
SHPALOSJA, SHPËRNDARJA DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT	26
SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL	28
NGRIRJA E TRANSAKSIONEVE BANKARE	29
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	31
<i>IV. BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE (TI)</i>	35
BUXHETI	36
ZHVILLIMI DHE FORCIMI I KAPACITETEVE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	38
<i>V. PRIORITETET STRATEGJIKE</i>	41
PLANI I PERFORMANCËS SË NJIF-K	42
LISTA E SHKURTESAVE	45

*I. POLITIKAT DHE  
KOORDINIMI VENDOR  
PËR PPP/LFT*

## VLERËSIMI I RREZIKUT, MENAXHIMI RREZIKUT DHE KORNIZA STRATEGJIKE

Përmirësimi i të kuptuarit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë mbetet ndër prioritetet strategjike të NJIF-K. Kjo synohet të realizohet përmes adresimit të gjeturave të NRA, vlerësimeve të rrezikut sektorial, dhe zhvillimi i masave për zbutjen e rrezikut, përfshirë rritjen e vetëdijes për sektorin publik, privat në lidhje me kërcënimet e PP / FT dhe përhapjes.

Gjatë vitit 2023, janë realizuar të paktën 10 aktivitete të trajnimeve, punëtorive, tryezave të përbashkëta në të cilat është diskutuar vlerësimi i rreziqeve të PP/FT.

Zhvillimi i vlerësimit të rrezikut sektorial dhe specifik në fushat përkatëse me fokus në sektorët dhe fushat më të rrezikuara, është përmbushur përmes hartimit të vlerësimit të rrezikut sektorial në fushat si në vijim:

- Vlerësimi i Riskut të pastrimit të parave nëpërmjet produkteve bankare të ofruara në Kosovë;
- Vlerësimi i Rrezikut Specifik Sektorial për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit për OJQ-të.
- Vlerësimi rajonal i rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të personave juridik në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Menaxhimi i Rrezikut - nënkupton politikat, strategjitë dhe aktivitetet tjera të koordinuara që ndërlidhen me rrezikun, me qëllim të drejtimit dhe kontrollimit të organizatës.

Mekanizmi i menaxhimit të rrezikut për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit në Kosovë bazohet në standardet ndërkombëtare dhe përbëhet nga instrumentet e mëposhtme:

- Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut;
- Matrica e Analizës dhe Vlerësimit të Rreziqeve Individuale të identifikuara në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut;
- Plani i Veprimit për Masat e Trajtimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut në Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit;
- Vlerësimi i Rrezikut i Sektorit dhe Degës Specifike në ekonomi joformale, pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krime financiare në Kosovë;
- Strategjitë Kombëtare;
- Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare;
- Instrumenti i Monitorimit dhe Rishikimit për Strategjinë Kombëtare;
- Buxheti dhe Planet e Performancës të institucioneve relevante publike;
- Platforma që siguron partneritet mes institucioneve kombëtare të sektorit publik, privat dhe të tretë sa i përket hartimit, rishikimit, adoptimit, implementimit dhe monitorimit të instrumenteve të menaxhimit të rrezikut.

NJIF-K ka ndërmarrë një sërë veprimesh për përpilimin e informatave, statistikave dhe raporteve bazuar në vlerësimet e rreziqeve dhe bërjen e rekomandimeve për organet të tjera relevante, në lidhje me masat që duhet të merren, strategjitë që duhet të rishikohen dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.

Në këtë drejtim, Këshilli i Evropës po mbështet autoritetet e Kosovës në procesin e vlerësimit të rrezikut sektorial të OJF-ve për financimin e terrorizmit, sipas Metodologjisë së zhvilluar të Këshillit të Evropës. Për këtë qëllim dhe si vazhdim i dy punëtorive pasuese të mbajtura me mbështetjen e Projektit në shtator 2022 dhe në shkurt 2023 në Prishtinë, anëtarët e Ekipit Analitik dhe Koordinues prezantuan dhe diskutuan analizën dhe sintezën e informacionit të marrë përmes moduleve të mbledhjes së të dhënave, dhe kërkime në një takim të Grupit të Punës të mbajtur në Strasburg më datë 4 dhe 5 maj 2023. Pjesëmarrës nga Njësia e Inteligjencës Financiare, Banka Qendrore, Policia, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamentin për Regjistrimin e OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Brendshme, Shoqata e Bankave, Doganat, Administrata Tatimore, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Agjencia e Inteligjencës, Këshilli Prokurorial, dhe Shoqëria Civile ishin akterët kyç në këtë proces.

## **BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI KOMBËTAR DHE RISHIKIMI I EFEKTIVITETIT TË SISTEMIT KOMBËTAR TË PPP/LFT**

Autoritetet e vendit kanë ndërtuar mekanizmat koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe ngritja e bashkëpunimit ndër-institucional me qëllim të koordinimit të bazuar në rreziqet e identifikuar


Koordinimi dhe Implementimi i Planit të Veprimit i rekomanduar për përmirësimin e sistemit të LPP/LFT-së.

Me qëllim të forcimit të Koordinimit Kombëtar dhe rishikimit të efektivitetit të sistemit kombëtar të PPP/LFT, në nëntor 2023 është mbajtur takimi ndër-institucional, me qëllim për të diskutuar progresin e bërë dhe rezultatet e arritura. Takimi mblodhi së bashku përfaqësues të institucioneve përfutuese në Kosovë, ekipin e projektit PECK III dhe zyrën e BE-së në Prishtinë. Anëtarët e grupit punues diskutuan për rezultatet e arritura në periudhën raportuese si dhe për aktivitetet e vazhdueshme dhe të ardhshme.

Plani i Veprimit i rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/ Luftimin e Financimit të Terrorizmit, është duke u zbatuar nga autoritetet e vendit.

Bazuar në mjetin e monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit të rekomanduar për Përmirësimin e Sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/ Luftimin e Financimit të Terrorizmit (efektiviteti), të dhënat tregojnë për progres të arritur në disa fusha.

**Grafiku 1. Statusi i implementimit të rekomandimeve**



Progres i theksuar është arritur në adresimin e veprimeve të rekomanduara, në veçanti në rezultatin e menjëhershëm 3 (Fuqizimi I strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse - Mbikëqyrja), Rezultatin e menjëhershëm 5 (Fuqizimi i aftësive për identifikimin e pronësisë përfituese dhe për të kufizuar keqpërdorimin e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike për qëllime të PP/FT -Personat dhe marrëveshjet juridike), dhe rezultatin e menjëhershëm 11 (Financimi i përhapjes, sanksioneve financiare).

### **FORCIMI I LEGJISLACIONIT KOMBËTAR PËR PPP/LFT**

Politikat dhe masat efektive kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit janë kyçe për integritetin dhe stabilitetin e sistemit financiar dhe ekonomisë së vendit.



Ndër zhvillimet kryesore sa i përket kornizës ligjore për PPP/LFT, ishte hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara. Me hyrje në fuqi të këtij ligji, Kosova ka bërë progres në pajtueshmërinë sa i përket përafrimit të saj me standardet e FATF-së konkretisht Rekomandimi 6 (sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit) dhe Rekomandimi 7 (sanksionet financiare të shënjestruara lidhur me përhapjen).

Me datë 12/04/2023, NjIF-K ka publikuar Udhëzuesin (NjIF-K) Nr. 01/2023 për Zbatimin e Detyrimeve për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT) për profesionistët ligjor. Ky udhëzues synon të ndihmojë profesionistët ligjor në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, duke u mundësuar që të kuptojnë rreziqet e PP/FT që ekzistojnë në sektorin e tyre dhe të zbatojnë një qasje të bazuar në rrezik ndaj detyrimeve të tyre për LPP/LFT. Qasja e bazuar në rrezik është thelbësore për zbatimin efektiv të kornizës për LPP/LFT.

Gjatë vitit 2023 është punuar edhe në hartimin e një Udhëzuesin për Sektorin e Organizatave Jofitimprurëse i cili pritet të adresoj çështjet që ndërlidhen me kryerjen e kontroleve të brendshme në lidhje me rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit tek ky sektor.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023 pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara, MFPT në koordinim me NjIF-K dhe mbështetjen e Projektit PECK III, ka krijuar dy grupe punuese për hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e tij. Njëri akt nënligjor ndërlidhet me zbatimin e procedurës së propozimeve nga autoritetet shtetërore për përcaktimin e personave në listën vendore dhe njëri lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga Ligji për Sanksione Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara për subjektet raportuese.

Tutje përgjatë vitit 2023 është punuar në finalizimin Koncept-Dokumenti për Trajtimin e Fushës së Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit të cilin me datë 27/12/2023 me Vendimin Nr. 16/180 Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar. Koncept-Dokumenti për Trajtimin e Fushës së Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit është dokument që hap rrugën për hartimin e ndryshimeve ligjore në fushën e PPP/LFT për përafrimin e më tutjeshëm të kornizës ligjore me standardet e rishikuar të FATF dhe Direktivave të Be-së në këtë fushë.

## *II. MBIKËQYRJA E PAJTUESHMËRISË DHE MASAT PARANDALUESE*


## MBIKËQYRJA E BAZUAR NË RREZIK

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese mbështetet nga një kornizë gjithëpërfshirëse të mbikëqyrëse të bazuar në rrezik. NJIF-K ka zhvilluar Metodologjinë për zbatimin e një kornize mbikëqyrëse të bazuar në rrezik për PPP/LFT. Korniza mbikëqyrëse që është miratuar nga NjIF-K synon të sigurojë strukturë mbikëqyrëse efektive për të qenë në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në Standardet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF).

Kjo kornizë mbikëqyrëse e bazuar në rrezikun nga PP/FT mbështetet në gjashtë funksione kryesore për të arritur objektivin në menaxhimin e shëndoshë të rrezikut të PP/FT nga subjektet raportuese:


- Bashkëpunimi
- Licencimi ose regjistrimi
- Vlerësimi i rrezikut
- Ndhimja e subjektit raportues
- Monitorimi 'off-site' dhe inspektimet në terren
- Veprim korrigjues

Grafiku 2. Korniza mbikëqyrëse e bazuar në rrezikun nga PPP/LFT



Gjatë vitit 2023, NJIF-K ka realizuar gjithsej 37 inspektime të pajtueshmërisë në subjektet raportuese, apo 37% më tepër krahasuar me vitin paraprak 2022. Plani vjetor i inspektimeve është planifikuar dhe realizuar kryesisht duke u përqendruar në inspektimet me fushëveprim të kufizuar dhe inspektime pasuese.

Grafiku 3: Inspektimi i Pajtueshmërisë sipas llojit 2023




Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për inspektimet në vend dhe në distancë në vitet 2019-2023.

Tabela 1: Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca 2019-2023

Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2019-2023										
Subjektet raportuese të inspektuara	2019		2020		2021		2022		2023	
	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
Banka	1	2	1	-	2	-	-	-	-	-
Institucione Mikrofinanciare	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-
Kompani të Sigurimit dhe Sigurimit të Jetës	2	1	-	-	-	-	-	-	-	-
Zyrat e Këmbimit Valutor	-	-	-	-	2	-	7	-	-	-
Agjencionet për transfere të parave	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-
OJQ	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Auditor & Kontabilistë	-	-	-	19	2	-	-	-	-	-
Avokat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	13
Noterët	-	17	-	-	-	24	1	19	-	23
Agjencionet për patundshmëri	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Auto Sallone	-	-	10	-	-	-	-	-	-	-
Inspektimet në vend dhe distancë	5	20	12	19	7	24	8	19	1	36
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë	25		31		31		27		37	

Në dekadën e fundit, një fokus i theksuar i mbikqyrjes është përqendruar në sektorët e identifikuar me rrezik si noterët, bankat, institucionet mikrofinanciare, zyret e këmbimit valutor etj.

Grafiku 4.: Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca 2014-2023



## BASHKËPUNIMI PËR MBIKËQYRJEN E PAJTUESHMËRISË

Bashkëpunimi ndërmjet agjencive mbikëqyrëse është thelbësor për vendosjen e një regjimi efektiv mbikëqyrës.

Bashkëpunimi i NJIF-K me mbikëqyrësit sektorial të pajtueshmërisë është i mbështetur kryesisht në nenin 38 të Ligjit për PPP/LFT, Marrëveshje të Bashkëpunimit, praktikat më të mira ndërkombëtare dhe parime të përgjithshme, të cilat përgjithësisht fokusohen në:

- Bashkëpunimin përmes shkëmbimit të informacionit;
- Bashkëpunimi përmes aktiviteteve të përbashkëta të mbikëqyrjes;
- Punë të përbashkëta për zhvillimin e udhëzimeve, udhëzuesve dhe manualeve;
- Kërkesat në lidhje me konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave;

- Caktimin e pikave të përbashkëta të kontaktit brenda NjIF-K dhe mbikëqyrësve sektorialë të autorizuar për të bashkëvepruar në mënyrë rutinore për çështjet që lidhen me bashkëpunimin;
- Modalitete të tjera bashkëpunimi të cilat kryesisht fokusohen në ndarjen e listës së RTD-ve të mundshme menjëherë pas përfundimit të inspektimit; kur mbikëqyrësi sektorial dyshon ose identifikon aktivitete, të cilat janë ose mund të lidhen me PP/FT, ai menjëherë informon NjIF-K në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit LPP/LFT;
- Organizimin e përbashkët të aktiviteteve vetëdijësuese me subjektet raportuese etj.

Progres i theksuar në këtë drejtim, është arritur përmes nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Njësisë për Inteligjencë Financiare dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ky memorandum i nënshkruar me datë 14 Korrik 2023 është bërë në frymën e bashkëpunimit



dhe interesit të ndërsjellë, si dhe ka për qëllim të lehtësoj shkëmbimin e informacionit dhe ngritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

BQK dhe NjIF-K mbeten partnere të fuqishme në përpjekjet e përbashkëta për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Për më tepër, NjIF-K dhe BQK kanë ngritur kapacitet dhe njohurit për mbikqyrjen e bazuar në rrezik, përmes projektit të të mentorimit në vendin e punës. Qëllimi i programit të mentorimit ishte që të ofrojë udhëzime praktike dhe këshilla të ekspertëve për proceset e vazhdueshme operative që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e LPP/LFT nga distanca dhe në vend të subjekteve raportuese. Pjesëmarrësit nga Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Banka Qendrore të ndikuar pozitivisht nga shkëmbimi peer-to-peer, ndërmorrën masa në përmirësimin e praktikave mbikëqyrëse në Kosovë duke forcuar më tej qasjen e bazuar në rrezik në përputhje me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Pjesëmarrësit theksuan gjithashtu se një qasje e bazuar në rrezik do të integrohet në të gjitha aspektet e hartimit të një programi mbikëqyrës të pajtueshmërisë për PPP/LFT.

## **PARTNERITETI PUBLIK-PRIVAT**

Përforcimi i Partneritetit Publik-Privat mbetet ndër objektivat strategjike të NJIF-K për t'u realizuar. Për realizimin e këtij qëllimi, një delegacion i NJIF-K ka kryer një vizitë studimore në Mbretërinë e Bashkuar nga data 15 - 17 nëntor 2023. Kjo vizitë studimore është realizuar si pjesë e një projekti që Qeveria Britanike po ndërmerr me Njësinë e Inteligjencës Financiare (FIU) në Kosovë.

Vizita ka përfshirë disa takime me partnerët relevant në Londër në Qendrën Kombëtare të Krimin Ekonomik (NECC), FIU-në e Mbretërisë së Bashkuar dhe Taskforcën e Përbashkët të Hetimit të Pastrimit të Parave (JMLIT) me synimin për të përmirësuar të kuptuarit tonë se si funksionojmë me njëri-tjetrin, duke ndarë më mirë praktikën dhe përmirësimin e fluksit të informacionit dhe komunikimit ndërmjet vendeve tona përkatëse, për të trajtuar kërcënimin e pastrimit të parave dhe flukseve të paligjshme financiare.

Mësimet e përfituara nga vizita studimore në Mbretërinë e Bashkuar do të shërbejnë për të zbatuar ato në praktikë, në veqanti në themelimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe partneritetit publik-privat për të mbështetur dhe koordinuar përgjigjen e Kosovës në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlidhura penale.

Dy punëtoritë të njëpasnjëshme më 27 dhe 29 nëntor 2023, janë organizuar nga NJIF-K dhe PECK III lidhur me sanksionet e shënjestruara financiare. Të dy punëtoritë ofruan një platformë për diskutim mbi standardet e FATF të përfshira në Rekomandimet 6 dhe 7 dhe Udhëzuesin e praktikave më të mira të BE-së, si dhe dispozitat e zbatueshme për autoritetet kompetente dhe subjektet raportuese, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Financave, Prokurorinë e Shtetit, Agjencinë e Inteligjencës, NJIF-K, Banka Qendrore, Dogana, Administrata Tatimore, Policia, Agjencia Kadastrale, sektorin bankar, noterë dhe auditorë.

Pjesëmarrësit gjithashtu ngritën ndërgjegjësimin dhe njohuritë praktike mbi sfidat dhe praktikat e mira krahasuese që ndërlidhen me zbatimin e sanksioneve financiare të shënjestruara kundër terrorizmit dhe financimit të terrorizmit, si dhe kundër financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, duke përfshirë zgjidhje për të përmirësuar dhe forcuar ligjin dhe politikat përkatëse.





Trajnim për zbatimin e legjislacionit për sanksione financiare ndërkombëtare të shënjestruara. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të ofrojë kontakt me institucionet përkatëse kompetente dhe subjektet raportuese dhe të rrisë ndërgjegjësimin për standardet ndërkombëtare dhe zbatimin e legjislacionit vendës për sanksionet

e shënjestruara financiare ndërkombëtare.

Në kuadër të fuqizimit të partneritetit publik-privat, nën organizimin e Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) është mbajtur konferenca me temën "Krijimi i vlerave - Porta e së ardhmes" për nderë të javës



ndërkombëtare të Profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit. Konferenca ka pasur për qëllim diskutimin rreth trendëve, raportimeve dhe zhvillimeve të fundit me qëllim të promovimit të përgjegjësisë sociale përmes praktikave më të mira për transparencë dhe llogaridhënien shërbim të interesit publik, përfshirë edhe parandalimin e pastrimit të parave. Përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfshirë NJIF-K kanë ndarë perspektivat e tyre për t'i adresuar çështjet që ndërlidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe zbatimin e praktikave më të mira në këtë fushë. . Për më tepër, nga përgjegjësit në NjIF-K u ligjërua lidhur me temën "Përgjegjësitë e profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit në parandalimin e pastrimit të parave"



*III. MBLEDHJA,  
ANALIZIMI,  
SHPËRNDARJA*

## MBLEDHJA E INFORMACIONIT FINANCIAR

Përmirësimi i aftësive të brendshme të NJIF-K për operative, analiza si dhe zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar, mbetet ndër prioritetet me rëndësi për NJIF-K. Kjo synohet të arrihet përmes zhvillimit, standardizimit dhe intensifikimit të proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave.

Në rrugëtimin gjithnjë në zhvillim të inteligjencës financiare, NJIF-K mbetet e përkushtuar në angazhimin e saj për të mbrojtur sistemet financiare të vendit kundër flukseve të paligjshme financiare.

Të dhënat dhe raportet e pranuar tregojnë përkushtimin dhe punën e palodhur të stafit të NJIF-K, me synimin për të siguruar suksesin e vazhdueshëm të Njesisë. Përveç përbushjes së mandatit të saj ligjor, në kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit, dhe kryerjes së funksioneve të saj thelbësore, NJIF-K ka luajtur një rol kyç në mbështetjen e sektorit publik dhe privat përmes përpjekjeve të gjera të ofrimit të udhëzueseve dhe materialeve tjera informuese. Për të garantuar integritetin e sistemit financiar, NJIF-K ka punuar ngushtë me palët e interesit, duke përfshirë sektorin financiar dhe BPCJF, organet rregullatore dhe mbikqyrëse, agjencitë e zbatimit të ligjit, etj.

NJIF-K përdor një qasje të bazuar në rrezik, prandaj, prioritizimi është i rëndësishëm pasi lejon institucionin të ndajë ose drejtojë burimet në përputhje me prioritetet dhe rreziqet e identifikuar. Një model i vlerësimit të rrezikut përdor vlerat numerike për të përcaktuar kategorinë e rrezikut (i ulët, i mesëm dhe i lartë). Bazuar në shkallën e rrezikut, të dhënat vendosen sipas prioritetit, duke zgjedhur njërin nga tri opsionet sipas prioritetit:

- Prioritet i ulët,
- Prioritet normal ose
- Prioritet i lartë

Priority:  Low  Normal  High

Bashkëpunimi efektiv me partnerët e fushës së PPP/LFT ka vazhduar edhe në vitin 2023. Qëllimi i NJIF-K është të ofrojë inteligjencë financiare të përshtatshme për nevojat e përdoruesit

përfundimtar. Qëllimi kryesor i inteligjencës është të ndihmojë në vendimmarrje, duke përfshirë por pa u kufizuar në: mbështetjen e përdoruesit përfundimtar në planifikimin e aktiviteteve të tyre. Ky cikël mund të përfshijë një hetim i ri penal, një procedim të mëtutjeshëm apo plotësues, një hetim penal në vazhdim, një parandalim / zbulim të aktivitetit kriminal ose një hetim lidhur me gjurmimin e aseteve/rikuperimin e aseteve, pezullimin e transaksioneve ose sanksionet vendore dhe ndërkombëtare.

Rëndësia e bashkëpunimit të fortë vendor dhe ndërkombëtar në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve të lidhura me të dhe financimit të terrorizmit, duke vënë në dukje se përpjekjet e kombinuara të NJIF, janë thelbësore për të trajtuar kompleksitetin e aktiviteteve kriminale.

Transformimi digjital dhe integrimi i iniciativave të Inteligjencës Artificiale dhe modernizimit të sistemeve të NJIF-K, do të sigurojë potencial në rritje të inteligjencës financiare. Megjithatë, elementi njerëzor mbetet i domosdoshëm. Profesionistët e aftë janë thelbësorë për përshtatjen dhe zhvillimin me përparimet teknologjike.

Gjithashtu, rëndësia e përforcimit të mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe partneritetit publik-privat, mbeten ndër prioritetet strategjike të NJIF-K. Këto partneritete do të ndikojnë ndjeshëm në rritjen dhe ndarjen e inteligjencës financiare dhe përpjekjet për fuqizimin e masave të PPP/LFT.

Padyshim që NjIF-K ka zhvilluar në vazhdimësi një marrëdhënie të ngushtë me partnerët e saj të zinxhirit të LPP/LFT, e cila është si rezultat i përpjekjeve dhe investimeve në shumë dimensione në këtë rrugëtim, prandaj natyra dhe sasia e bashkëpunimit ndërmjet palëve ka vazhduar të intensifikohet. NjIF-K është i kënaqur me këtë zhvillim pozitiv, pasi mundësohen shumë konsultime ndërmjet NjIF-K dhe, në veçanti, autoriteteve të zbatimit të ligjit, sektorit privat dhe palëve të interesit, gjë që padyshim rrit efektivitetin në lidhje me përdorimin e inteligjencës financiare. Qëllimi i vazhdueshëm është të jepet një kontribut domethënës në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes. Për më tepër, NJIF-K synon të mbështesë gjurmimin dhe rikuperimin e suksesshëm të aseteve brenda zinxhirit të LPP/LFT. Gjurmimi dhe rikuperimi i aseteve është një objektiv strategjik i politikës së NJIF-K.

Pranimi i raporteve të dyshimta në numra të qëndrueshëm paraqet një përpjekjeve të komunikimit dhe udhëzimit në vazhdimësi të Njesisë me sektorin privat, i cili është i dukshëm kur përdoret raportimi i shtuar si pikë referimi. Kjo u vu re sidomos në sektorin e Noterisë i cili kishte një ngritje prej 183% të raportimit të RTD-ve.

Grafiku 5: Numri i RTD-ve të raportuara 2019-2023





Tabela 2: Raportet e transaksioneve/aktiviteteve të Dyshimta të pranura sipas sektorëve

SUBJEKTET RAPORTUESE	2019	2020	2021	2022	2023
Bankat	785	710	661	620	607
Institucionet Mikrofinanciare	17	13	27	12	7
Sektori i sigurimeve	5	1	1	-	-
Agjencionet për Transfer Parash	137	149	182	259	145
Lizingjet financiare	3	5	6	5	6
Institucionet tjera Financiare (IFJB)	-	-	0	21	17
Avokatët	1	1	2	1	-
Noterët	76	17	34	35	99
Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor	1	-	-	-	-
Auto Sallonet	-	3	0	2	1
Autoritetet kompetente	-	1	-	-	-
Mbikëqyrësit sektorial	1	-	2	-	-
Tjera	1	2	5	5	6
<b>Gjithsej raportet për vite</b>	<b>1027</b>	<b>902</b>	<b>920</b>	<b>960</b>	<b>888</b>

### Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

Në vitin 2023, NjIF-K ka pranuar 3,050 raporte në para të gatshme me gjithsej 1,081,644 transaksione (RTG) ose mesatarisht rreth 90,137 transaksione në muaj. Kjo është një ngritje prej 7% krahasuar me vitin 2022 në të cilin vit ishin raportuar 1,006,729 transaksione në para të gatshme.

Grafiku 6: Numri i RTG-ve të pranuarra 2019-2023



Edhe në vitin 2023 ka vazhduar të ketë ngritje të raportimit të RTG-ve nga tregtarët me vlera të larta, auto-sallonet. Gjatë vitit 2023, Auto-Sallonet kanë raportuar rreth 145 raporte të transaksioneve në para të gatshme.

Tabela 3: Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) të pranuarra

Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) të pranuarra		
Subjekti raportues	Viti 2023	
	Numri i Raporteve të pranuarra	Numri i Transaksioneve
<b>Bankat dhe Institucionet Financiare</b>		
Bankat	2,657	1,078,263
IFJB-të	60	62
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	287	3225
Agjensionet për Transfer Parash	46	94
<b>Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare</b>	<b>3,050</b>	<b>1,081,644</b>
<b>BPCJF-të dhe entitetet tjera raportuese</b>		
Auto Sallonet	145	1205
Dogana e Kosoves	12	2046
<b>Gjithsej ENTITETET TJERA RAPORTUESE</b>	<b>12</b>	<b>3251</b>
<b>Gjithsej RTG-të e pranuarra</b>	<b>3,062</b>	<b>1,084,895</b>

**Raportimi i Deklarimit Kufitar (BCR)**

*Sipas kërkesave ligjore të nenit 33 të Ligjit 05/L-096 për PPP/LFT, secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart instrumente monetare në vlerën prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë, apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, paraqet me shkrim shumën e instrumenteve monetare dhe burimin e tyre të verifikueshëm në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Dogana e Kosovës, para zyrtarit doganor.*

Gjatë vitit 2023, NJIF-K ka pranuar 2,046 BCR. Krahasuar me vitin paraprak 2022, numri i raportimeve ka shënuar ngritje prej 16%.

Tabela 4: Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2014-2023

Vitet	Numri i Raporteve të deklaruar		
	Personat Juridik	Personat Fizik	Numri i deklarimit të RTG-ve
1	2	3	4 = (2+3)
2023	1,310	736	2,046
2022	1,240	528	1,768
2021	1,388	388	1,776
2020	554	232	786
2019	650	319	969
2018	816	396	1,212
2017	664	444	1,108
2016	732	424	1,156
2015	606	658	1,264
2014	667	583	1,250
Gjithsej	8,627	4,708	13,335

Mejete montare të ndaluara nga Dogana e Kosovës gjatë vitit 2023 janë gjithsej 259,700 euro dhe 140,270 dinar. Vlera e mjeteve të konfiskuara prej 25% siç përcaktohet në paragrafin 5 të nenit 33 të Ligjit 05/L-096 për PPP/LFT, ka qenë në shumë prej 62,816.64 euro.

*"Personi i cili nuk respekton dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të nenit 33 të Ligjit 05/L-096 për PPP/LFT, kryen veprë të kundërvajtjes që dënohet me gjobë prej njëzet e pesë përqind (25 %) të shumës totale të instrumenteve monetare në posedim për të cilat ka detyrim për të deklaruar".*

Tabela 5: Mosdeklarimi i mjeteve monetare gjatë vitit 2023

Nr.	Shuma e pa dekluar	VALUTA	Shuma e mjeteve te konfiskuara	VALUTA
1	30,870	Euro	25% (7,717.50)	Euro
2	28,650.00	Euro	25% (7,162.50)	Euro
3	16,840 € 20,520 rsd	Euro Rsd	25% (4,210)	Euro
4	40,000.00	Euro	25% (10,000.00)	Euro
5	12,750.00	Euro	25% (3,187.50)	Euro
6	65,000.00	Euro	25% (16,250.00)	Euro
7	11,480.00	Euro	25% (2,870)	euro
8	35,200.00	Euro	25%(8,800.00)	euro
9	9,455.00 119,750.00	Euro RSD	25% (2,619.14)	Euro

Indikatorët e pastrimit potencial të parave të shënuar më poshtë synojnë ngritjen dhe vetëdijesimin e subjekteve raportuese në pajtim me PPP/LFT. Këta indikatorë në vijim nuk nënkuptohet se janë të vetmit, por ofrojnë shembuj për mënyrat më bazike se si mund të bëhet pastrimi i parave.

*Tabela 6: Indikatorët e PP/FT '2023*

Indikatorët e PP/FT	Nr. i indikatorëve në RTD/RAD	Indikatorët e PP/FT	Nr. i indikatorëve në RTD/RAD
Aktiviteti i llogarisë është jo-konsistent dhe nuk korrespondon me profilin e klientit;	291	Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë nga lokacione të ndryshme gjeografike;	12
Pastrim i parave	224	Korrupsioni dhe përfshirja e PEP-ve vendor dhe ndërkombëtar	10
Qarkullim i lartë në llogarinë që përfshin shuma të konsiderueshme të fondeve në para në të gatshme;	153	Llogari biznesi përmes të cilave bëhet numër i madh i transfereve hyrëse dhe dalëse elektronike dhe për të cilat duket se nuk ka ndonjë biznes logjik apo qëllim ekonomik, veçanërisht kur ky aktivitet është në, përmes apo nga vendet të cilat ngritin shqetësime	10
Blerja e asetëve në vlerë të lartë (p.sh. patundshmëri, vetura luksoze);	110	Pastrimi i parave i bazuar në tregti	9
Strukturimi i fondeve përmes transfereve apo transaksioneve;	100	Përdorimi i kazinovë dhe aktiviteteve të lojërave të fatit dhe Strukturimi i blerjeve të basteve, pagesave dhe tërheqjeve;	8
Evazion Fiskal / Kontrabande / Krimet e taksave	95	Drogat narkotike dhe substanca psikotrope - Transferime të shumta fondesh, të cilat duket se janë të lidhura me një vend me rrezik të lartë të drogës	7
Depozitime të rregullta të shumëfishta në para në të gatshme të cilat duket se janë të ndërlidhura dhe nën pragun raportues prej 10,000 Euro të transaksionit të parave në të gatshme;	72	Përdorimi i teknologjive/metodave të reja të pagesave	7
Tjera	101	Raportet negative - ndërkombëtare	7
Transaksioni nuk ka ndonjë qëllim racional (të qartë dhe relevant) ekonomik apo biznesor;	64	Tërheqjet në para në të gatshme kryhen në degë të ndryshme bankare dhe/ose ATM, në të njëjtën ditë;	6
Depozitimi apo tërheqja e parave në të gatshme apo instrumenteve të shumëfishta monetare në shumat të cilat në të vazhdueshme janë shumë afër nën-pragun identifikues apo raportues;	55	Kompanitë apo institucionet financiare të përfshira janë themeluar në vendet të njohura si "parajsat" tatimore apo qendrat "offshore";	5
Transaksione të ngjashme të kryera përgjatë një periudhe të shkurtë kohore;	46	Llogaritë që pranojnë depozitime relevante periodike e të cilat pasivizohen gjatë periudhave tjera;	5
Transaksioni nuk është ekonomikisht i arsyeshëm, duke pasur parasysh biznesin dhe profesionin e bartësit të llogarisë;	46	Transfertet bankare të urdhëruara në shuma të vogla në një përpjekje të dukshme për të shmangur nxitjen e kërkesave për identifikim ose raportim;	5
Depozitimet në para në të gatshme në vlera të larta për të paguar transferet ndërkombëtare të fondeve;	40	Mos-përputhjet e pashpjegueshme që rrjedhin nga procesi i identifikimit apo verifikimit të klientit (për shembull, përkitazi me shtetin e mëparshëm apo të tanishëm të banimit, shtetit që ka lëshuar pasaportën, shtetet e vizituara sipas pasaportës, dokument	4
Depozitime të mëdha në para në të gatshme të bëra në llogarinë individuale apo të personit juridik ku normalisht aktiviteti i biznesit të individit apo personit juridik mund të bëhet në metoda tjera të pagesës;	22	Transaksionet dhe kompanitë e përfshira janë nga shtetet apo juridiksionet jo-bashkëpunuese të përcaktuara nga FATF si dhe transferet ndërkombëtare të fondeve të dërguara në juridiksionet që paraqesin rrezik të lartë	4
Mashtrim-et dhe përdorimi i dokumenteve false;	20	Transferet dalëse korrespondojnë të jenë transfere hyrëse të fondeve që duken të jetë transaksion 'kthyes';	4
Përdorimi i llogarive të huaja të anëtarëve të familjes, palëve të treta dhe/ose të emëruarve etj;	20		
Raportimet e pafavorshme në media lokale dhe bazat e të dhënave tregtare dhe ndërkombëtare	20		
Transaksionet e shumëfishta të cilat duket të jenë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë tek i njëjtit përfitues apo transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje me përfituesit e përbashkët;	17		



## ANALIZA DHE MONITORIMI

### Pikat thelbësore të dhënave të pranuar dhe analizuara në vitin 2023



#### Inteligjenca Financiare e shpërndarë

Në vitin 2023, 191 raporte të inteligjencës u referuan agjencive të zbatimit të ligjit për hetime të mëtutjeshme. Vlera e transaksioneve fondeve të ngrira nga NJIF-K në vitin 2023 ka vazhduar duke arritur të identifikoj transaksione të dyshimta dhe t'i ngrijë rreth 1.7 milion euro.



#### Të dhënat dhe raportet e proceduara

Në vitin 2023, NJIF-K regjistroi gjithsej 6,271 raporte të cilat janë proceduar në sistemin elektronik të përpunimit të dhënave. Këto të dhëna kanë shërbyer për analiza më të thelluara të raporteve.



#### Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme dhe ndërkufitare

NjIF-K ka pranuar 3,050 raporte në para të gatshme (RTG) dhe 1,529 Raportime të Deklarimit Kufitar (BCR) në 2023



#### Mbikëqyrja e Pajtushmërisë

Intensifikimi i mbikëqyrjes së bazuar në risk ka vazhduar duke ndërmarrë 37 inspektime të pajtushmërisë. Janë forcuar kapacitetet përmes mentorimit të mbikëqyrjes së bazuar në risk.



#### Pranimi dhe analizimi i raporteve të dyshimta

NjIF-K ka pranuar 888 RTD/RAD në vitin 2023 ose mesatarisht 74 RTD/RAD në muaj. Është zhvilluar analiza paraprake sipas qasjes së bazuar në rrezik dhe janë ndërmarrë veprime tutje të analizës së thelluar.



#### Shkëmbimi kombëtar i informatave dhe kërkesat e pranuar për analizim

Gjatë vitit 2023, NJIF-K ka pranuar gjithsej 214 kërkesa për shkëmbim të informacionit. Numri më i lartë i kërkesave edhe gjatë këtij viti ka rrjedhur nga Policia e Kosovës, AKI, Prokuroria, Dogana etj.



#### Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave


Në vitin 2023, NJIF-K shkëmbeu me partnerët ndërkombëtar 95 informacione të inteligjencës financiare

# SHPALOSJA, SHPËRNDARJA DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Me qëllim të zbatimit të legjislacionit vendor, si dhe standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare të FATF dhe Egmont Grupës, është e rëndësishë qenësore që të kemi procese efikase dhe të sigurta për shkëmbimin e informatave dhe shpërndarjen e inteligjencës ndërmjet NjIF-K-së dhe autoriteteve kompetente në lidhje me pastrimin e parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.

Shpërndarja është pjesa e ciklit të inteligjencës ku NjIF-K shpërndan produktin final të inteligjencës tek autoritetet kompetente, ndërsa menaxhimi i shpërndarjes së inteligjencës i referohet procesit që përfshin organizimin e shpërndarjes së inteligjencës së përfunduar

Figura 1. Analiza dhe Procesi i Inteligjencës



Autoritetet kompetente vendore me të cilat NjIF-K shpërndanë raporte të inteligjencës janë organet publike ose qeveritare të Kosovë që pranojnë informacion nga NjIF-K, dhe i cili informacion është relevant për hetimin në kuadër të kompetencave të tyre përkatëse. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:


- Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Doganat;
- Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;
- Policinë e Kosovës,;
- Prokurorinë Speciale;
- Administratën Tatimore; dhe
- çdo autoritet tjetër relevant (duke përfshirë rregullatorët dhe mbikëqyrësit sektorial në fushën e PPP/LFT) në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Informatat e Inteligjencës së NjIF-K të shqyrtuara për shpërndarje dalëse do të klasifikohet sipas kriterëve të rrezikut varësisht prej rezultateve të analizës:

- Urgjent
- Rrezik i lartë
- Rrezik Mesatar (Shpërndarje standarde)
- Rrezik i ulët

Në vitin 2023, NJIF-K ka shpërndarë për hetime të mëtutjeshme gjithsej 191 raporte të inteligjencës financiare, apo 9% më tepër se vitin paraprak 2022.

*Grafikoni 7: Raportet e shpërndara të inteligjencës 2019-2023*



Në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhënat e raporteve të shpërndara nga NJIF-K në pesë vitet e fundit (periudha 2019-2023):

*Tabela 7: Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2019-2023*

Autoriteti kompetent	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Policia e Kosovës</b>	74	73	84	65	68
<b>Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës/Prokurorit Themelore</b>	5	19	12	8	22
<b>Administrata Tatimore e Kosovës</b>	52	46	76	84	86
<b>Dogana e Kosovës</b>	0	2	4	3	3
<b>Agjencia e Kosovës për Inteligjencë</b>	4	7	8	3	0
<b>Agjencia Kundër Korrupsionit</b>	1	0	0	0	0
<b>EULEX</b>	0	0	0	0	0
<b>FIU ndërkombëtare/Informacion Spontan</b>	15	12	16	12	12
<b>Tjera</b>	2	3	4		
<b>Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës</b>	<b>153</b>	<b>162</b>	<b>204</b>	<b>175</b>	<b>191</b>


## SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

Promovimi i bashkëpunimit me agjencionet tjera për zbulimin, parandalimin dhe hetimin e pastrimit të parasë /financimit të terrorizmit dhe përforcimi i identifikimit, gjurmimit të ardhurave nga krimi/financimi i terrorizmit dhe ngrirja e aseteve është një nga objektivat specifik të NJIF-K. Gjatë vitit 2023, NJIF-K ka pranuar gjithsej 214 kërkesa për shkëmbim të informacionit. Numri më i lartë i kërkesave edhe gjatë këtij viti ka ardhur nga Policia e Kosovës (65% e gjithsej kërkesave të pranuar).

Tabela 8: Shkëmbimi i informacionit - vendor viti 2023


Institucionet parashtruese të kërkesës	Nr.kërkesave
Policia e Kosovës	140
AKI	30
Prokuroria e Shtetit & PSRK	15
ATK	5
Dogana e Kosovës	10
BQK	11
Tjera	3
<b>Gjithsej</b>	<b>214</b>

Grafiku 8: Shkëmbimi i informacionit - ndihma hetimore e ofruar për agjencitë e zbatimit të ligjit



Kërkesat për shkëmbim të informacionit (IRD) ndërlidhen me një hetim të filluar nga një shpërndarje e inteligjencës së NJIF-K të rrjedhur nga RTD-të që janë shpërndarë për hetime të mëtutjeshme në një agjenci të zbatimit të ligjit.

*Grafiku 9: Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF 2016-2023*




### **NGRIRJA E TRANSAKSIONEVE BANKARE**

Ligji 05/L-096 për PPP/LFT, neni 27 përcakton kompetencën e NJIF-K për ngrirjen e përkohshme e transaksioneve:

*NjIF-K mund të lëshojë urdhër me shkrim për subjektet raportuese për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve, nëse vlerëson se ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit në lidhje me transaksionin ose personin që kryen transaksionin, për të cilin informon prokurorinë dhe organet tjera, kompetente në mënyrë që të marrin masa brenda kompetencave të tyre.*

Numri i udhëzimeve të lëshuara nga NJIF-K në vitin 2023 për pezullim të transaksioneve ose ngrirjen e përkohshme e transaksioneve, ka qenë gjithsej 6 urdhëra për ngrirje, në vlerë totale të transaksioneve të pezulluara/ngrira prej 1,649,557 Euro.

Grafiku 10: Vlera e transaksioneve/fondeve të ngrira nga NJIF-K 2016-2023



Qëllimi i ngrirjes së transaksioneve është që të parandaloj pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit si dhe rikthimin e të ardhurave nga krimi.

Tabela 9: Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2019-2023

Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i udhëzimeve të lëshuara për pezullim të transaksionit	3	31	46	30	6
Shuma (EUR)	151,060	1,093,643	8,975,202	5,015,244	1,649,557

## BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e PPP/LFT mbetet ndër prioritetet në agjenden e mekanizmave ndërkombëtar dhe të organiatave ndërkombëtare. Gjithashtu, NJIF-K ka në prioritetet e saj strategjik përforsimin e këtij bashkëpunimi me vlerë. Gjatë vitit 2023, rreth 100 raporte të inteligjencës janë analizuar në fushën e shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit.

Po kështu, NJIF-K siguron që për të qenë në përputhje me pritshmëritë ndërkombëtare, t'i jepej mbështetje në kohë dhe e vlefshme homologëve të saj të huaj.

Në kryerjen e funksionit të saj analitik, NJIF-K në mënyrë të ngjashme, përveç vëllimit të kërkesave për informacion, i kushton rëndësi të veçantë edhe raporteve spontane të inteligjencës të dërguar nga homologët e huaj apo të shpërndara nga vet NJIF-K tek homologët e saj të huaj.

### Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve

Tabela 10: Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave i pranuar 2019-2023

Bashkëpunimi ndërkombëtar	2019	2020	2021	2022	2023
<b>KËRKESAT E PRANUARA</b>					
Kërkesat e huaja të pranuar nga NjIF-K	26	32	43	37	28
Kërkesat e huaja të refuzuara nga NjIF-K	0	0	0	0	0
Ndarja spontane e informacionit të marrë nga NjIF-K	19	28	21	12	21
<b>GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i pranuar)</b>	<b>45</b>	<b>60</b>	<b>64</b>	<b>49</b>	<b>49</b>

Tabela 7: Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave i dërguar 2019-2023

Bashkëpunimi ndërkombëtar	2019	2020	2021	2022	2023
<b>KËRKESAT E DËRGUARA</b>					
Kërkesat e dërguara nga NjIF-K tek homologët e huaj	74	42	55	61	37
Ndarja spontane e informacionit të dërguar nga NjIF-K	15	13	18	11	9
<b>GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i dërguar)</b>	<b>89</b>	<b>55</b>	<b>73</b>	<b>72</b>	<b>46</b>

Grafiku 11: Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2015-2023



Frekuenca më e shpeshtë e shkëmbimit gjithëpërfshirës të informatave me tre anëtarët e Egmont Group, midis 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2023, ishte si me homologët nga Shqipëria, Gjermania dhe Zvicra.

Gjatë vitit 2023 është realizuar një vizitë studimore në Gjermani me temë “Praktika dhe hetimet ne kripto asete”. Kjo vizitë kishte për synim që përfaqësuesve të prokurorive, organeve policore kosovare dhe Njesisë Kosovare për Inteligjencë Financiare dhe Bankës Qendrore t’i ofrojë informacione praktike nga metodat hetimore dhe të ndjekjes penale duke u përqendruar në Kripto-asete në kontekstin e luftës kundër pastrimit të parave. Njohuritë e përfituara do të kontribuojnë në përforcimin e aftësive të anëtarëve të delegacionit në fushën e krypto-aseteve, posaçërisht për synimet e pastrimit të parave, dhe mbështetjen e qëndrueshme të bashkëpunimit ndërmjet të dy vendeve. Vizita ishte realizuar në Institucionet gjermane si Institucioni Federal për Mbikëqyrjen e Shërbimeve Financiare (BaFin), Frankfurt; Zyra Qendrore për Hetimet e Transaksioneve Financiare - Njësia për Inteligjencë Financiare, Këln; Prokuroria e Përgjithshme Këln, Zyra Qendrore dhe Pritëse për Krimin Kibernetik, Nordrhein-Westfalen (ZAC), Prokuroria e Përgjithshme e Frankfurtit - Zyra Qendrore për luftën kundër kriminalitetit në Internet (ZIT); Zyra Federale Kriminale, Wiesbaden.



Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me homologët ndërkombëtar, U.d.Drejtorit të NJIF-K ka zhvilluar një takim me Drejtorin e Zyrës Qendrore për Hetimet e Transaksioneve Financiare - Njësia për Inteligjencë Financiare, në Këln, Gjermani.

### Memorandumet e Mirëkuptimit

Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2023 ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi (MoU) me katër njësi homologe ndërkombëtare:


























- FIU Malta - Financial Intelligence Analysis Unit,
- FIU Guatemala - Superintendency of Banks through the Special Verification Intendency (IVE), of the Republic of Guatemala,





- FIU Luxembourg - CRF, Financial Intelligence Unit (FIU-LUX),
- FIU DR Congo - National Financial Intelligence Unit of Democratic Republic of the Congo (CENAREF)

Tabela 11: MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj

MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj		
	Juridiksioni	Viti
	Shqipëria (DPPPP)	2009
	“Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë” (MLPD)	2009
	Mali i Zi (APML)	2009
	San Marino (FIA)	2009
	Sllovenia (OMLP)	2009
	Kroacia (AMLO)	2010
	Turqia (MASAK)	2012
	Republika Çeke (FAU-CR)	2012
	Finlanda (FIU)	2013
	Polonia (GIIF)	2014
	Shqipëria (DPPPP) - ripërtëritje	2014
	Hungaria (HFIU)	2015
	Maqedonia (FIO) - ripërtëritje	2015
	Ghana (FIC)	2015
	Lituania (FNNTT)	2016
	Jordania (AMLU)	2018
	Senegal (CENTIF)	2018
	Mali i Zi (FIU)	2019
	Taiwan (AMLD)	2020
	Arabia Saudite (SAFIU)	2022
	Japan (JAFIC)	2022
	Malta (FIAU)	2023
	Guatemala (IVE)	2023
	Luxembourg (CRF)	2023
	DR Congo (CENAREF)	2023

## MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

NJIF-K është institucion përfitues i disa projekteve dhe donatorëve ndërkombëtar, ku ndër më të rëndësishmet janë:

- Projekti i financuar nga BE-ja&KiE PECK III
- Mbështetja e UNDP ndaj përpjekjeve anti-korrupsion në Kosovë (SAEK) - Mbështetja për NJIF-K
- Programi Global i Luftimit të Flukseve Financiare të Paligjshme (FPF) - Projekti i GIZ<sup>1</sup>
- Mbështetja nga Misioni i OSBE në Kosovë;
- Fondacioni gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ);
- iPROCEEDS - Projekti i financuar nga BE-ja&KiE (fusha e Cyber)
- Mbështetja nga Ambasada e SHBA dhe Britanisë së Madhe dhe Programet regjionale.

---

<sup>1</sup> Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) - German-Norwegian Cooperation in Combating Illicit Financial Flows in the Western Balkans

*IV. BUXHETI, BURIMET  
NJERËZORE DHE  
TEKNOLOGJIA  
INFORMATIVE (TI)*

## BUXHETI

Sipas Ligji Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, për NjIF-K është ndarë shuma prej 544,581 Euro si dhe realizimin e shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2023 që është në vlerë prej 459,300 Euro ose e shprehur në përqindje 84.34 %.

Në vazhdim janë paraqitur shpenzimet për kategoritë ekonomike si në vijim:

1. Buxheti i shpenzuar për vitin fiskal 2023, për Kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve është 228,262 Euro ose 85.34 %.
2. Buxheti i shpenzuar për vitin fiskal 2023, për Kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve është 195,181.48 Euro ose 82.82 %.
3. Në kategorinë e shërbimeve komunale, vlera e shpenzuar për këtë kategori ekonomike është 7,896 Euro ose 68.81 %.
4. Në kategorinë e Investimeve Kapitale, vlera e shpenzuar për këtë kategori ekonomike është 27,961 Euro ose 93.20 %.

*Tabela 12: Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2023*

Kategoritë Ekonomike	Buxheti aprovuar për vitin 2023	Buxheti i shpenzuar	Realizimi %
	ndarja fillestare	realizimi	
	1	2	3
Paga dhe mëditje	267,448	228,262	85%
Mallra dhe shërbime	235,658	195,181	83%
Shpenzimet komunale	11,475	7,896	69%
Shpenzime kapitale	30,000	27,961	93%
<b>Gjithsej</b>	<b>544,581</b>	<b>459,300</b>	<b>84%</b>

## Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Njësinë për Inteligjencë Financiare

	<u>Shënim</u>	2023	2022	2021
		<u>Llogaria e vetme e Thesarit BKK</u>	<u>Llogaria e vetme e Thesarit BKK</u>	<u>Llogaria e vetme e Thesarit BKK</u>
		'000	'000	'000
<b>BURIMET E FONDEVE -PRANIMET</b>				
Granti qeveritar		544,581	475,316	467,515
Të hyrat vetanake				
Të hyrat e dedikuara				
Të hyrat nga AKP				
Grantet e përcaktuara të donatorëve				
Fiancimet e huamarrjes				
Klauzola e investimeve				
Fondi zhvillimor në mirëbesim				
Pranimet tjera -kthimii depozitave				
<b>Gjithsej</b>		<b><u>544,581</u></b>	<b><u>475,316</u></b>	<b><u>467,515</u></b>
<b>SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT</b>				
Operacionet				
Paga dhe shtesa	2	228,262	205,060	229,157
Mallra dhe shërbime	3	195,181	161,801	156,165
Shpenzime komunale	4	<u>7,896</u>	<u>7,143</u>	<u>7,112</u>
		<u>431,339</u>	<u>374,004</u>	<u>392,434</u>
Transferet				
Transfere dhe subvencione	5			
Shpenzime kapitale	6	27,961	29,789	13,450
Prona, ndërtesa dhe pajisje				
Pagesa tjera -kthimii depozitave	7			
<b>Gjithsej</b>		<b><u>459,300</u></b>	<b><u>403,793</u></b>	<b><u>405,884</u></b>

## ZHVILLIMI DHE FORCIMI I KAPACITETEVE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Teknologjia informative (TI) është duke e përshkuar dhe transformuar ekonominë në tërë globin, si në sektorin publik ashtu edhe shoqërinë në përgjithësi. Ky trend drejt transformimit digjital e ka



vendosur promovimin e NJIF-K dhe sektorit të TI-së si prioritet kryesor dhe zhvendosjen e prioriteteve në drejtim të zbatimit të programeve qeveritare dhe për të qenë në trend me botën.

Përveç kësaj, me një vlerë të madhe të tregut botëror, industria e TI-së nuk është vetëm sektori me rëndësi, por edhe më dinamik, gjë që e bënë TI-në motorin

kryesor të rritjes së performancës dhe inovacionit.

Gjatë vitit 2023, janë arritur rezultate të përmirësimit dhe zhvillimit në hartimin, mirëmbajtjen dhe implementimin e një planit vjetor për infrastrukturën e TI-së së NJIF-K. Është bërë përmirësimi i bazave aktuale të të dhënave dhe zhvillimi i tyre me qëllim të përmirësimit të cilësisë së analizave strategjike dhe operacionale.

Ndër të arriturat kryesore në zhvillimin e Teknologjisë Informative dhe transformim digjital në Njësinë për Inteligjencë Financiare të Kosovës janë::


- **Vlerësimi Sektorial i Rreziqeve të Sistemit të TI**

Sistemi i TI-së në NJIF-K është sistem i avancuar, hyn në sistemet me rëndësi strategjike shtetërore, është i ndërlidhur ngushtë me sigurinë kombëtare, posedon informacione të klasifikuara. Gjatë vitit 2023, është bërë Vlerësimi Sektorial i Rreziqeve të sistemit të Teknologjisë Informative.

Të gjeturat e këtij vlerësimi planifikohet të inkorporohen në Planin e Veprimit dhe Përfomancës të vitit 2024.

- **Zhvillimi i modulit të listës së integruar online të sanksioneve**

Është hartuar plani ideor i projektit për ri-dizajnimin dhe zhvillimin e modulit të listës së integruar online të sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara. Ky projekt pritet të realizohet përmes zhvillimit të ueb faqes kërkimit të shpejtë të gjitha listave të sanksioneve të cilat i zbaton Kosova.



Duke përmirësuar dhe ridizajnuar Listën e Sanksioneve, NJIF-K do të rriste nivelin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut. Implementim i plotë i këtij moduli planifikohet në vitin në vijim.

- **Strategjia e Teknologjisë Informative për NJIF-K 2024 - 2026**

Strategjia e TI-ve për vitet 2024-2026 e hartuar nga një grup i ekspertëve të NJIF-K ka definuar një plan të rrugës se si të kapërcehet hendeku midis gjendjes aktuale të Sektorit të TI-së dhe gjendjes së tij të dëshiruar.

Strategjia ka synuar të paraqes një përmbledhje të nivelit të lartë të: Sistemit të TI-së e që mbulon misionin e tij, vlerat thelbësore, objektivat dhe qasjet për përmbushjen e qëllimeve të tij; një përmbledhje e projekteve dhe iniciativave aktuale dhe të ardhshme të TI-së me afate kohore si dhe një katalog i arkitekturës ekzistuese, kapacitetet dhe mundësit e TI-së, nevojat dhe kërkesat e ardhshme të infrastrukturës, stafi dhe burimet tjera të nevojshme.

Strategjia e Teknologjisë Informative NJIF-K përmban një analizë të përparësive dhe dobësive të sistemit të TI-së.

Prioritetet kryesore strategjike të përcaktuara në objektivat e kësaj strategjie janë me sa vijon:

- Modernizimi i Rrjetit të Sigurte
- Modernizimi i Rrjetit të jashtëm
- Rritja e shfrytëzimit të goAML sistemit dhe përmirësimi i kualitetit të dhënave
- Modernizimi i Ueb faqes së NJIF-K
- Ngritja e aftësive profesionale dhe kapaciteteve të Sektorit të TI-së

Objektivat e Strategjisë së Teknologjisë Informative NJIF-K planifikohet të inkorporohen në Planin e veprimit dhe performances të viteve 2024-2026

- **Avancim i Planit Backup/Restore të TI-së**

NJIF-K gjatë vitit 2023 me sukses ka ri-dizajnuar një plan të avancuar Backup/Restore dhe e ka realizuar me sukses mbështetjen e këtij plani me softuer shumë të avancuar për Backup/Restore dhe pajisje shtesë harduerike si Server , Sefa të Sigurtë etj.

Po ashtu Sektori i TI-së ka hartuar Plan Propozimin detal të kërkesave teknike dhe të sigurisë dhe koston për lokacionin rezervë për backup jashtë NJIF-K.

- **Upgrade goAML**



NJIF-K posedon sistemin shtetëror të informacionit dhe komunikimit të quajtur goAML.

Përmes këtij sistemi, në harmoni me nenin 4 të Ligjit 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, kryhet raportimi, kërkimi, marrja, analizi dhe shpërndarja tek autoritet kompetente dhe bërja publike e informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

Gjatë vitit 2023, NJIF-K ka kryer me sukses upgrade nga versioni 4.4 në versionin 5.2

Versioni i ri i goAML i mundëson NJIF-K të vazhdoj me përparime në:

- Shfrytëzim më efektiv të workflow-ve
- Menaxhim më të mirë të rasteve
- Shfrytëzim më të madh të Raporteve të ndryshme
- Rritje e tools-ve në dispozicion për kërkesa për informacione dhe shpërndarje të informacioneve
- Metoda të reja efektive për kërkime
- Rritje e mundësive për bashkëpunim me Agjencitë tjera shtetërore.

## • Ndërlidhja e bazave të të dhënave

Spektori i TI-së dhe Operativës kanë vazhduar punën për ndërlidhjen e bazave të dhënave duke hulumtuar mundësitë e rritjes së numrit të Institucioneve me të cilat NJIF-K ka lidhje direkte apo vetëm qasje. Raporti i vlerësimit të mundësive për qasje në bazën e të dhënave të institucioneve tjera planifikohet të realizohet gjatë vitit të ardhshëm.

## • Avancim i Infrastrukturës së TI-ë



NJIF-K me sukses ka realizuar buxhetin vjetor të ndarë për investime në sistemin e Teknologjisë Informative.

Investimet kryesore infrastrukturore lidhen me Server, Printer, sefat e sigurisë së lartë dhe update i softverit të specializuar Device Lock.

NJIF-K në baza vjetore vazhdon me furnizimin me Server pasi zëvendësimi i tyre në baza të rregullta sipas standardeve të TI-së shton sigurinë e operimit të tyre dhe minimizon rreziqet e ndonjë prishjeje me pasoja katastrofike.



*V. PRIORITETET  
STRATEGJIKE*

## PLANI I PERFORMANCËS SË NJIF-K

Plani i performancës për vitin 2023 përshkruan detyrat, misionin, vizionin, qëllimet, prioritetet strategjike, objektivat dhe veprimet e Njesisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NjIF-K). Ky plan gjithashtu përmban planin për alokim të resurseve dhe kontroll të brendshëm.

Plani i performancës 2023 përcakton se si NjIF-K do të bazohet dhe mbështetet në asetet e saj dhe të arriturat për t'i përmbushur dhe tejkaluar sfidat me të cilat do të ballafaqohet gjatë periudhës një vjeçare dhe se si do të mbajë pozitën e vet si një ndër njësitë kredibile të inteligjencës në Kosovë dhe në rajon. Ky plan gjithashtu tregon se si NjIF-K do të matë suksesin e vet, dhe si do të kontrollojë proceset e veta të brendshëm.

Prioritetet Strategjike dhe objektivat e planit të performancës së NjIF-K në nivel institucional rezultojnë prej planeve të veprimit të strategjive kombëtare, vlerësimit të rreziqeve kombëtare dhe sektoriale, vlerësimit të gjithëmbarshtëm të vendit në fushën e PPP/LFT, programit të Qeverisë, PKIE, PKZH, buxhetit dhe raporteve dhe dokumenteve tjerë që janë në interes për NjIF-K.

Objektiva e NjIF-K do të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të afatizuara, si dhe do të adresojnë problemet dhe shkaqet e tyre të cilat janë hasur gjatë punës për zbatimin e mandatit të NjIF-K.

NjIF-K monitoron progresin drejt arritjes së prioritetëve strategjike përmes objektivave specifike dhe llogari-dhënëse, të cilat implementohen duke u bazuar në planet e veprimit. Suksesi i institucionit vlerësohet duke përdorur indikatorët kyç të performancës.

Me qëllim të përmbushjes së misionit të tij, Njësia për Inteligjencë Financiare (NjIF-K) synon të realizojë objektivat e parapara në kuadër të Planit të Performancës për vitin 2024.

1. Zhvillimi dhe përforcimi i dokumentit të Politikave dhe Koordinimi vendor për PPP/LFT-në;
2. Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe masat parandaluese;
3. Përmirësimi i aftësive të brendshme të NjIF-it për operativë, analiza si dhe zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar;
4. Forcimi i kapaciteteve të NjIF-K

Rezultat e pritura	Aktivitetet	Produkti (Output)
<b>I. Zhvillimi dhe përforcimi i dokumentit të Politikave dhe Koordinimi vendor për PPP/LFT-në</b>		
I	1.1. Fuqizimi i vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizës strategjike	Produkti 1.1.1: Përforcimi në identifikimin, vlerësimin dhe të kuptuarit e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e përhapjes, bashkërendimi i veprimeve brenda vendit për të luftuar PP dhe financimin e terrorizmit e përhapjen, përdorimi i vlerësimit/vlerësimeve të rreziqeve si bazë për hartimin dhe caktimin e përparësive të politikave dhe aktiviteteve të PPP/LFT-së
	1.2. Bashkëpunimi & Koordinimi Kombëtar dhe rishikimi i efektivitetit të sistemit kombëtar të PPP/LFT	Produkti 1.2.1. Numri i rritur i takimeve të mekanizmave koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuar
	1.3. Forcimi i legjislacionit Kombëtar për PPP/LFT dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore (legjislacionit sekondar) duke forcuar standardet e brendshme të NjIF-K, sigurimin e implementimit të tyre efikas dhe duke ofruar udhëzime për subjektet raportuese	Produkti 1.3.1. Arritjet në përgatitjen e propozimit për ndryshim dhe amendamentit të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit Produkti 1.3.2. Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore (legjislacionit sekondar) dhe ofrimi i udhëzimeve për subjektet raportuese Produkti 1.3.3 Forcimi i standardeve të brendshme të NjIF-K dhe sigurimi i implementimit të tyre efikas
<b>II. Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe Masat parandaluese</b>		
II	2.1. Intensifikimi i mbikëqyrjes së bazuar në risk dhe ngritja e bashkëpunimit për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë	Produkti 2.1.1. Arritjet në hartimin dhe implementimin e planit vjetor për mbikëqyrje të pajtueshmërisë Produkti 2.1.2. Ngritje numrit të inspektimeve në vend dhe nga distanca Produkti 2.1.3. Përqindja (%) e arritjes në ngritjen e bashkëpunimit me mbikëqyrësit sektorial për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë
	2.3. Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe përforcimi i partneritetit Publiko-Privat	Produkti 2.3.1. Zhvillimi/ mirëmbajtja dhe implementimi i planit vjetor për aktivitetet e NjIF-K përmes rritjes së vetëdijesimit, trajnimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit dhe përforcimit të partneritetit publiko-privat
<b>III. Përmirësimi i aftësive të brendshme të NjIF-it për operativë, analiza si dhe zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar</b>		
III	3.1. Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave	Produkti 3.1.1. Përqindja (%) e arritjes në krijimin dhe implementimin e Procedurave Standarde të Operimit për Inteligjencën Strategjike dhe operacionale dhe analiza
	3.2. Promovimi i bashkëpunimit me agjencionet tjera për zbulimin, hetimin e pastrimit të parasë /financimit të terrorizmit dhe përforcimi i identifikimit, gjurmimit të ardhurave nga krimi/financimit të terrorizmit dhe ngrirja e aseteve	Produkti 3.2.1. Numri i ngritur i takimeve, diskutimeve, punëtorive me institucioneve me qëllim përdorimin e inteligjencës financiare për qëllimet e hetimeve dhe ndjekjeve penale të PP-së Produkti 3.2.2. Përqindja (%) e arritjes në përdorimin e informacionit për transaksionet në para të gatshme dhe instrumentet monetare që lëvizin përtej kufirit për të zhvilluar raste të PP-së të mundshme dhe veprave penale të ndërlidhura dhe FT-së
	3.3. Forcimi i bashkëpunimit me NjIF homologe të huaja, me Egmont, dhe	Produkti 3.3.1. Përqindja (%) e arritjes në ngritjen dhe zhvillimin e inteligjencës financiare ndërkombëtare me qëllim të zhvillimit të

	ngritja e bashkëpunimit me vendet e rajonit	<p>parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi</p> <p>Produkti 3.3.2. Përqindja e arritjes për pjesëmarrje ne takimet plenare të grupit Egmont, në pjesëmarrjen grupet punuese të organizatës, dhe pjesëmarrje në punën e NJIF-ve te rajonit dhe takime tjera regjionale</p>
--	---	---

**IV. Forcimi i kapaciteteve të NjIF-K**

IV	4.1. Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe administrative të NJIF-K	<p>Produkti 4.1.1. Përqindja e arritjes në hartimin/ mirëmbajtjen dhe implementimin e Planit të Përformancës të NJIF-K që përcakton proceset e brendshme të NjIF-K për planifikimin buxhetor, performancën dhe burimet (azhurnim vjetor)</p> <p>Produkti 4.1.2. Përqindja e arritjes në azhurnimin dhe implementimin e vlerësimit të nevojës për trajnime, strategjisë dhe programit për trajnime për luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit duke marrë parasysh nevojat e brendshme dhe të jashtme të NjIF-K</p> <p>Produkti 4.1.3. Përqindja e arritjes në hartimin/ mirëmbajtjen e një plani vjetor me afate kohore për secilin vit financiar në përgatitje të propozimit buxhetor të NjIF-K dhe planit të agjencionit për performancë dhe burime</p>
	4.2. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të IT-së	<p>Produkti 4.2.1. Përqindja (%) e arritjes në hartimin/ mirëmbajtjen dhe implementimin e një plani vjetor për infrastrukturën e TI-së së NJIF-K</p> <p>Produkti 4.2.2. Përqindja (%) e arritjes në Menaxhimin e sistemeve të IT, bazave të të dhënave dhe trajnimet</p>

## LISTA E SHKURTESAVE

NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
LFT	Luftimi i Financimit të Terrorizmit
LPP/LFT	Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
AIF	Raporti i informacioneve shtesë
AK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AKI	Agjencia e Kosovës për inteligjencë
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPCJF	Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (brenda PK)
DK	Dogana e Kosovës
DKT	Drejtoria kundër Terrorizmit – (brenda PK)
DRNOJQ	Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë
FATF/TFVF	Task Forca e Veprimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FT	Financimi i Terrorizmit
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të dhënave
IFJB	Institucionet Financiare Jobankare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit
IMF	Institucion Mikrofinanciar
IPA	Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (i Komisionit Evropian)
KDK	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
KiE	Këshilli i Evropës
KKLKE	Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MF	Ministria e Financave
MM	Marrëveshje e mirëkuptimit
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës

OJQ	Organizatë joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ONK	Oda e Noterëve të Kosovës
PECK	Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë”
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht.
PK	Policia e Kosovës
PP	Pastrimi i parave
PSO	Procedura Standarde të Operimit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare (paraardhësi i NJIF-it)
RKSOKB	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raporti i transaksionit në të gatshme (kesh)
SHBK	Shoqata e Bankave të Kosovës
SHKÇAK	Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës
TI	Teknologjia Informative
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër krimit dhe drogave
VRK	Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut
ZKK	Zyra Kadastrale Komunale



Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Prishtinë,  
Kosovë

Tel: +383 38 248360

<http://fiu.rks-gov.net>

fic@fic-ks.org

